KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Shtator 2023

11.10.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin shtator 2023, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 4,2% vjetore dhe 0,9% mujore

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0,9% në muajin shtator 2023. Norma vjetore e inflacionit e matur në muajin shtator 2023 me muajin shtator 2022 ishte 4,2%.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Shtator 2023 / Shtator 2022 4,2%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4,2% në muajin shtator 2023, krahasuar me muajin shtator 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perime (25,4%); pemë (14,1%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (11,0%); prodhime ushqimore (9,6%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (9,3%); gjëra dhe pajisje të tjera rekreative, kopshte dhe manare (7,4%); pije joalkoolike (7,1%); pije alkoolike, duhan (6,6%); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (6,5%); kujdes personal (5,9%);

shërbime për transport (5,5%); bukë dhe drithëra (5,3%); restorante dhe hotele (4,3%); energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (4,1%); shërbime ambulantore (4,1%); shëndetësi (3,6%); rekreacion dhe kulturë (3,5%); veshje dhe këpucë (3,4%); mish (2,7%); mallra dhe shërbime të ndryshme (2,7%); dhe qumësht, djathë dhe vezë (1,5%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 4,4 për qind në IHÇK.

Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajra dhe yndyra (-12,7%) dhe përdorim i pajisjeve për transportin personal (-1,1%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,2 për qind) në IHÇK.

Shtator 2023 / Gusht 2023 0,9%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,9% në muajin shtator 2023, krahasuar me muajin shtator 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOPI-it: lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6,4%); transport (2,9%); strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (1,8%); bukë dhe drithëra (1,7%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1,0 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (-7,0%) dhe shërbimet për transport (-3,7%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0,1 për qind) në IHÇK.

Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, Kosovë

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2023 në ‰	IX - 2023 2015=100	IX - 2023 VIII- 2023	IX - 2023 IX- 2022
00	Gjithsej IHÇK	1000	129,5	0,9	4,2
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	381,9	142,3	0,4	5,5
02	Pijet alkoolike, duhani	64,4	137,2	0,6	6,6
03	Veshje dhe këpucë	41,1	106,1	0,6	3,4
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,4	121,0	1,8	3,9
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	62	120,0	-0,1	5,5
06	Shëndetësia	24,1	116,4	0,9	3,6
07	Transporti	182,9	128,5	2,9	2,0
08	Mjetet e komunikimit	21,9	114,4	-0,2	-0,4
09	Rekracioni dhe kultura	36,6	105,3	0,3	3,5
10	Arsimi	5,9	104,0	-0,9	1,5
11	Restorantet dhe hotelet	32,1	129,3	0,2	4,3
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	57,8	116,9	-0,6	2,7

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Shtator 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation